



# BACHELOR

## FINANCË DHE KONTABILITET

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

# Pse ky program studimi?

Programi i studimit Financë dhe Kontabilitet, i zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin BOKU, ofron një formim të plotë teorik dhe praktik në fushën e financës, kontabilitetit dhe menaxhimit financiar.

Programi është konceptuar për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në ekonomi dhe agrobiznes.

Përmes këtij programi, studentët zhvillojnë aftësi në hartimin e planeve buxhetore, analizën e investimeve dhe menaxhimin e riskut financiar, duke përdorur koncepte dhe praktika moderne të financës dhe kontabilitetit.


Të diplomuarit përgatiten për karrierë në institucione financiare, biznese, administratë publike dhe në sektorin e agrobiznesit.

**Diplomë që njihet ndërkombëtarisht**



## Përshkrimi i programit

Programi ofron një formim akademik në financë dhe kontabilitet, duke integruar njohuri nga ekonomia, menaxhimi dhe analiza financiare. Strukturimi i krediteve siguron një balancë mes teorisë dhe praktikës, ndërsa një pjesë e moduleve zhvillohet në gjuhën angleze, duke forcuar përgatitjen akademike dhe profesionale të studentëve.



# Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit në programin Financë dhe Kontabilitet formohen si profesionistë me aftësi teorike, praktike dhe ndërdisiplinare në menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe analizën ekonomike. Ata mund të ushtrojnë profesionin si:

- **Specialist ose Menaxher Financiar** në biznese private, institucione publike dhe organizata jofitimprurëse;
- **Kontabilist ose Auditues** në kompani, banka, institucione financiare dhe agjenci qeveritare;
- **Analist Financiar dhe Konsulent Investimesh**, duke mbështetur vendimmarrjen strategjike dhe planifikimin ekonomik;
- **Ekspert për Menaxhimin e Riskut dhe Buxhetimin Financiar** në organizata të ndryshme, përfshirë sektorin e agrobiznesit.



**Florinda Zherri**

Pedagoge UBT

“Ky program më frymëzoi të vazhdoj rrugën akademike dhe të ndaj të njëjtat vlera dhe njohuri me studentët e mi. Financa gjithashtu më dha njohuri praktike dhe perspektiva të reja mbi menaxhimin e burimeve.”



**Henri Ndreca**

Drejtor i Përgjithshëm i T-Blocks

“Studimet në Financë-Kontabilitet ndërtuan themelin e lidershit tim, duke më pajisur me mendim strategjik, disiplinë analitike dhe vizion për inovacion. Si drejtues, këto kompetenca përkthehen në vendimmarrje të qëndrueshme dhe zhvillim të vazhdueshëm të biznesit.”



**Fatmir Nikolli**

Drejtor Rajonal dhe Drejtor i Segmentit të Bujqësisë (NOA, SHA)

“Studimet në Financë-Kontabilitet më dhanë mundësinë për të udhëhequr me vizion dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në nivel rajonal.”



**Esmeralda Doçi**

Përgjegjëse Sektorit të Kontabilitetit të Përgjithshëm, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

“Studimet në këtë degë më ndërtuan bazën e fortë profesionale dhe integritetin e nevojshëm për të menaxhuar me përgjegjësi financat publike dhe për të garantuar transparencë në administrim.”

# Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- Njohuri të avancuara në financë dhe kontabilitet për sektorin bujqësor dhe sektorë të tjerë ekonomikë.
- Aftësi analitike dhe përdorimin e metodave dhe software-ve bashkëkohore për analizën financiare dhe marrjen e vendimeve.
- Kompetenca në raportimin financiar, menaxhimin e riskut dhe zbatimin e standardeve të kontabilitetit.
- Aftësi në planifikimin financiar, buxhetimin dhe zhvillimin e projekteve të investimeve në bujqësi dhe agrobiznes.
- Kapacitete për hartimin e politikave ekonomike dhe vlerësimin e ndikimit financiar, ekonomik dhe social të programeve dhe politikave publike.

## PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

### LËNDËT BAZË

Matematikë, Bujqësi e përgjithshme, Mikroekonomi, Makroekonomi, Matematikë financiare, Statistikë, Informatika e zbatuar, Anglisht biznesi, Kërkimi dixhital, Bazat e menaxhimit mjedisor.

### LËNDËT KARAKTERIZUESE

Kontabilitet, Kontabilitet kosto, Kontabiliteti i drejtimit, Bazat e financës, Financa publike, Financa rurale, Paraja dhe banka, Tregjet dhe institucionet financiare, Analiza financiare, Investimet, Drejtim financiar, Taksim, Statistikë biznesi.

### TË TJERA

Marketing, Bazat e legjislacionit të biznesit, Menaxhimi i tokës dhe ujit, Administrim dhe menaxhim publik, Kontabilitet publik dhe OJF, Drejtim i fermave, Drejtim turizmi, Analiza e zinxhirit të vlerës.

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

## Mundësi Punësimi:

- Institucione financiare dhe bankare, si menaxherë financiarë, analistë financiarë ose analistë krediti.
- Sektorin privat dhe OJF, si specialistë finance, kontabiliteti dhe këshillues financiarë.
- Sektorin publik, si specialistë buxheti, financash dhe sistemit fiskal.
- Organizata ndërkombëtare, sigurime dhe pasuri të paluajtshme, si specialistë financiarë ose konsulentë.

# Të dhënat e programit

## **Niveli i studimit**

Cikli i parë, Bachelor

## **Titulli akademik**

Bachelor në Financë dhe Kontabilitet

## **Kohëzgjatja**

3 vite akademike / 6 semestra

## **Kredite**

180 ECTS

## **Forma e studimit**

Me kohë të plotë

## **Gjuha e studimit**

Shqip / Anglisht

## **Kuota studimi**

120 studentë

## **Përfundimi i studimeve**

Provim formimi / Temë diplome



# Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



## Për më shumë informacion vizitoni:

[www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)

[info@ubt.edu.al](mailto:info@ubt.edu.al)

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

## MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Pas përfundimit të studimeve Bachelor, të diplomuarit mund të vazhdojnë studimet Master në fushën e Financës dhe Kontabilitetit, në një program të riorganizuar me dy profile: Financë-Bankë dhe Kontabilitet-Auditim, duke u përgatitur për role profesionale, menaxheriale dhe analitike në sektorin financiar, bankar dhe të auditimit.

## FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti\_bujqesor\_tiranes  
fea\_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare  
Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit - UBT- faqja zyrtare

*Për jetën dhe të ardhmen...*